



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Njësi: Unit:	Nr. Prot.: Prot. No.:
Jedënica: KEVP	Br. Prot.: 68
Nr. i faqeve: No. of pages:	Data: Date:
Br. stranica: 1	Datum: 28.09.2018
Prishtinë	

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Nr.i Ref.68/18

KOMISIONI PËE EDUKIM TË VAZH DUESHËM PROFESIONAL: në mbështetje të Nenit 5 paragrafi 2 lidhur me nënparagrafin 2.1 lidhur me nënparagrafin 2.10 të Rregullores për Edukim të Vazhdueshëm Profesional, nxorri këtë:

V E N D I M

- I. REVOKOHET akreditimi i aktivitetit me nr. protokollit 272 dhe 273, i parashtruesës “Instituti i Evropës Juglindore për Politika Shëndetësore dhe Sociale”.
- II. Parashtruesës i ndalohet aplikimi për akreditim të programit në periudhën kohore prej një (1) viti.

A r s y e t i m

Instituti i Evropës Juglindore për Politika Shëndetësore dhe Sociale (në vijim parashtruesja), në cilësi të OJQ-së, me datë 10.08.2018 ka parashtruar pranë OMK-së aplikacionin për akreditim të Konferencës me nr. të protokollit 296, dhe me datë 13.08.2018 aplikacionin për akreditim të Workshop-it me nr. të protokollit 297. Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional në takimin e mbajtur me datë 16.08.2018 ka vlerësuar se janë përmbushur kriteret për akreditim të programit, andaj në mbështetje të Nenit 13, paragrafi 7 të Rregullores për Edukim të Vazhdueshëm Profesional, ka caktuar taksën administrative në vlerë prej 400€ për akreditim të Konferencës dhe 300 € për akreditim të Ëorkshopit. Parashtruesja pas njoftimit lidhur me obligimet e lartëcekura, ka paraqitur publikisht programin si të akredituar nga ana e Odës dhe përsëri pas paralajmërimit se duhet të përmbushen ato obligime ka mbajtur aktivitetin e akredituar pa i përmbushur detyrimet që rrjedhin nga akti i akreditimit.

Meqenëse nuk janë përmbushur kushtet lidhur me pagesën e taksës për akreditim dhe në anën tjetër aplikuesja ka mbajtur aktivitetin për të cilin është dashur të përmbushen kushtet e tilla, Komisioni për EVP duke u mbështetur në dispozitat e Nenit 13 paragrafi 7 dhe Nenit 12 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 4, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i EVP.

Prishtinë, 28 shtator 2018



Kryetari i Komisionit për EVP
Prof. Dr. Shemsedin Sadiku

Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes ankese në afat prej 15 ditëve. Ankesa duhet t'i drejtohet Këshillit Drejtues të OMK.